



2012

RAPORT
VJETOR



RAPORT VJETOR

Për FIQ

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare me fokus në Filantropi, Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Sektorin e Sigurisë. FIQ, po ashtu përkrah projekte për qytetari aktive dhe mbrojtje të mjedisit, përmes Programit të Granteve. FIQ është themeluar në vitin 2000 prej një grupi të vogël njerëzish, të cilët kanë parë nevojën e aktivizimit të qytetarëve në proceset vendim-marrëse, si pasojë e luftës së Kosovës, në periudhën 1998-1999.

Ne kontekstin e ndryshimeve politike dhe ekonomike që kanë ndodhur në Kosovë dhe duke mbajtur në vëmendje misionin e rritjes dhe forcimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procese vendim-marrëse, FIQ ridimensionoj vizionin e vet duke përfshirë në gamën e aktiviteteve të veta jo vetëm çështje që lidhen me fushën e sigurisë dhe aktivizmit qytetar, por dhe programe tjera si dhënia grantesh për nisma lokale dhe filantropia.

“FIQ beson, se filozofia e politikave zhvillimore në një shoqëri demokratike duhet të reflektojë gjithëpërfshirjen e qytetarëve për të realizuar kështu nevojat e shoqërisë Kosovare për një bashkëpunim të mirëfilltë qytetarë - shtet”



Letër nga Drejtoresha Ekzekutive

Të nderuar lexues, bashkëpunëtorë, miq!
 Forumi për Iniciativa Qytetare ka kënaqësinë dhe nderin, t'ju ftoj që të lexoni dhe kuptoni nëpërmjet aktiviteteve të programuara dhe zhvilluara në vitin 2012, vizionin e vet, koherencën e programeve të punës dhe sinergjinë që FIQ përpaket të realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë dhe aktorë të tjerë kombëtarë, rajonal dhe ndërkombëtarë.
 Ndërsa shkruaj këtë mesazh nuk mund të mos reflektoj ndryshimet dhe dinamikat thuajse të përditshme me të cilat haset shoqëria kosovare, për rrjedhojë dhe Forumi për Iniciativa Qytetare si një organizatë e shoqërisë civile, që beson në përfshirjen e qytetarëve në politik-bërje dhe vendim-marrje.
 Ndërsa, Kosova si shtet me institucione të reja, por me një shoqëri civile të konsoliduar përpaket të ecë në rrugën e saj të rritjes dhe fuqizimit, elita politike qëndron në një diskordancë duke mbajtur larg debateve dhe diskutimeve të rëndësishme dhe jetësore pikërisht elitat e vërteta qofshin këto apolitike, akademike apo kulturore.

Është kjo një ndër kontradiktat thelbësore me të cilën FIQ nëpërmjet programeve të hartuara dhe zbatuara gjatë vitit 2012 është përballur. Qëndresa dhe kundërshtitë e FIQ janë kundër politikës klanore, të interesave të ngushta personale dhe aspak përfaqësuese të qytetarisë kosovare.

Viti 2012 ishte një vit i cili shënoi një seri aktiviteteve të FIQ për një nxitje të fuqishme të aktivizmit qytetar në procese vendim-marrëse.

Seminaret me komunitetin për zhvillimet në fushën e Energjisë të cilat FIQ i ka mbajtur në kuadër të pjesëmarrjes në konsorciumin kosovar KOSID, shpalosën parimet e FIQ të cilat pajtoheshin me brengat dhe shqetësimet e qytetarëve rreth situatës energjetike në vend.

Fushatat e FIQ në bashkëpunim me SAFERWORLD dhe partnerë lokalë të Kosovës shënojnë një vlerë të aktivitetit të FIQ në fushën e luftës kundër armëmbajtjes dhe përdorimit të armëve në kuadër të programit Sundimi i Ligjit.

Çmimi FIDES si një vlerë e FIQ shënon një ndër momentet më të suksesshme të punës së forumit në fushën e nxitjes së Filantropisë. Dhënia e çmimeve individuale, për kompani, apo përfaqësues të diasporës si shenjë mirënjohje për kontributet e tyre ndaj komuniteteve në nevojë të Kosovës shërbejnë si një nxitje dhe përhapje e mëtejshme e kulturës së filantropisë dhe dhënies për një të mirë të përbashkët.

Të nderuar lexues, nëpërmjet mesazhit tim të shkurtër, ju ftoj që të lexoni si vijon, pikërisht një përshkrim më të zgjeruar të aktiviteteve dhe thelbit të punës së Forumit për Iniciativa Qytetare si një kontribues i rëndësishëm në procesin e zhvillimit të demokracisë në Kosovë.

Miqësisht
Dajana Berisha
Drejtoresha Ekzekutive

Struktura programore dhe metodat e punës së FIQ

Filantropia, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Sundimi i Ligjit dhe Programi i Granteve përbëjnë strukturën programore të FIQ. Ndërkaq, hulumtimet dhe analizat, avokimi, zhvillimi i politikave dhe menaxhimi i projekteve, përbëjnë metodat e punës tonë.

Programet dhe aktivitetet

1.FILANTROPIA



FIQ beson se secili qytetar mund të luaj rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë dhe të inkurajojë të tjerët për këtë. Ndikimi i punës tonë dhe të tjerëve që mundohen të bëjnë ndryshime në shoqëri, shihet veç tjerash, përmes filantropisë dhe akteve filantropike. Në këtë drejtim FIQ, po punon me kompani dhe individë të cilët dëshirojnë të kontribuojnë për shoqërinë dhe ndajnë të njejtat vlera me ne. Filantropia ka nevojë për një rilindje dhe riadresim si koncept në Kosovë. Në këtë rrafsh, FIQ po punon në dy drejtime përmes Programit të Filantropisë; (i) vetëdijësimi mbi rëndësinë e filantropisë dhe (ii) inkurajimin e kompanive dhe individëve për të kontribuar financiarisht, çka do të sillte një zhvillim të qëndrueshëm.

Fëmijët për një ambient më të gjelbëruar, ka qenë një nga aktivitetet që FIQ ka ndërmarrë me shkollat fillore nëpër komunat kryesore të Republikës së Kosovës, ku fëmijë të veshur si lule dhe drunj, mbledhën fonde për rregullimin e oborreve të shkollave të tyre.



FIQ në korrik 2012, morri pjesë në Forumin për Zhvillim të Filantropisë në Ballkanin Perëndimor, të organizuar nga Rockefeller Brothers Fund, në Kollashin, Mal të Zi, ku u prezantuan ide nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe tri idetë më të mira u shpërblyen me një shumë ta caktuar, të nevojshme për hapjen ose vazhdimin e bizneseve të “gjelbërta”.

Gjatë muajit nëntor 2012, FIQ, në kuadër të Programit për Filantropi, organizoi Javën e Filantropisë në disa qytete të Kosovës.

Gjatë këtyre takimeve me bizneset lokale diskutimet u përqëndruan kryesisht në identifikimin e mundësive të bashkëpunimit në këtë drejtim. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2013, me qytetet dhe komunat tjera të Kosovës.

2.PROGRAMI I SUNDIMIT TË LIGJIT



FIQ, vazhdon traditën e ndarjes së Çmimit FIDES, çmim ky që mëton të njoh publikisht vlerat dhe kontributet në të mirën e përbashkët që bëjnë kompanitë, individët dhe grupet e organizuara për të mirën e përbashkët. Në një ceremoni solemne, me një pjesëmarrje prej rreth 300 pjesëmarrës, nga kori diplomatik, përfaqësues të institucioneve dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësues biznesesh vendore dhe nga diaspora, shoqëria civile dhe media. Dhënia e çmimit, vetvetiu u ofron mundësi shoqatave, organizatave joqeveritare dhe në përgjithësi përfituesve të donacionit, që publikisht të shprehin mirënjohjet e tyre për dhuruesin e donacionit. Në anën tjetër, çmimi do të bëjë të mundur që fituesit të gëzojnë edhe një përkrahje të gjerë publike për projektet që ata kanë mbështetur meaq bujari.

FIQ që nga formimi i saj si organizatë, ka punuar ngushtë me sektorin e sigurisë, ku siguria në komunitet ka qenë dhe mbetet fokusi kryesor. FIQ përveç që ka gjetur mbështetjen e madhe nga donatorët në këtë sektor, vazhdon të punoj edhe me partnerë, të cilët kanë mbështetur punën tonë për vite me radhë, ku kontributet e tyre padyshim që kanë treguar ndikimin e punës së përbashkët. Përmes këtij programi, ne kemi për qëllim që të vazhdojmë forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes dhe të ndihmojmë për të rritur sigurinë në komunitetet e synuara. Gjatë vitit 2012, Programi i Sundimit të Ligjit, ka zhvilluar aktivitete përmes tri projekteve; (i) Forumi për Siguri, (ii) Vend i Sigurt dhe (iii) Rritja e Mbikqyrjes Publike.

Në bashkëpunim me organizata partnere, FIQ ka publikuar disa analiza të politikave, ndër më kryesoret "Buxheti i Policisë së Kosovës; nevojat për buxhet shtesë dhe planifikim më të mirë financiar" (FIQ dhe GAP); "Politikat e sigurisë në komunikacion" (FIQ dhe INDEP) dhe "Policia e lagjes; policimi dhe siguria në bashkësi, zbatimimi i tyre dhe efektet në terren" (FIQ).

Të gjitha këto analiza, janë pasuar me organizimin e tryezave nëpër 5 deri 7 komuna të ndryshme të Kosovës, ku është diskutuar përmbajtja e tyre dhe janë dhënë rekomandimet shtesë, të cilat rekomandime i kemi adresuar nëpër institucionet gjegjëse, në këtë rast, institucione që merren me çështje të sigurisë.



Aktivitete tjera që janë ndërmarrë në kuadër të Programit të Sundimit të Ligjit janë:

Fushata kundër armëve “Koha për Veprim”, e cila sipas të dhënave nga komunat e ndryshme të Kosovës, ka patur sukses në përdorimin më të ultë të armëve të zjarrit nëpër festa.

Fushata tjetër e ndërmarrë nga FIQ në bashkëpunim me Policinë e Kosovës “Njiheni Policin Tuaj”, poashtu ka filluar të zhvillohet nëpër disa komuna të Kosovës dhe do të vazhdojë edhe në muajt e parë të vitit 2013. Qëllimi i saj është që për së afërmi qytetarët të njihen me metodologjinë e re të punës së Policisë së Kosovës dhe me policin e sektorit të tyre.



FUSHATË KUNDËR ARMËVE TË PALIGJISHME



OFOROGG
FORUM FOR OPEN SOCIETY



3.ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

FIQ ka parë nevojën që idetë “e gjelbërta dhe ekonomike” të jenë më prezente në publik. Ne besojmë se këto ide do të sjellin të mira në komunitet dhe do të shërbejnë si katalizatorë për zhvillim në rrafshin ambienta dhe ekonomik në Kosovë. Roli i shoqërisë është të krijojë qytetarë të pavarur.

Që një shoqëri të ecën përpara, duhet që idetë e qëndrueshme të jenë më prezente. FIQ merr përsipër të ndihmojë, avokoj dhe promovoj këtë lloj zhvillimi që për qëllim ka ndryshimin socio-ekonomik për njerëzit dhe komunitetet e tyre.

Me këtë program, FIQ ka filluar të punoj gjatë vitit 2012, fillimisht në sektorin e energjisë, ku jemi pjesë e Konsorciumit të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm KOSID. Me këtë synojmë të avokojmë për procese më transparente të sektorit të energjisë në Kosovë.

FIQ, si pjesë e KOSID, ka kontribuar në mobilizim dhe aktivizmin qytetar, duke organizuar komunitetet më të rrezikuara nga ndotja e ambientit në adresimin e problemeve, organizimin e seminareve, tryezave diskutimi dhe të tjera aktivitete të rëndësishme.



4.PROGRAMI I GRANTEVE



Programi i Granteve është një shtyllë e mirë e FIQ, në mbështetje të iniciativave të cilat kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes qytetare.

Gjatë vitit 2012, FIQ ka mbështetur me grante një numër projektsh me diversitet në qasje dhe adresim të problemeve në vend.

Mbështetja për Këshillin e Fshatit Smirë ka kontribuar në rritjen e mobilizimit qytetar në zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve në bashkësi, duke nxitur komunitetin për të qenë aktiv në adresimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

“Miq të Kafshëve të Kosovës” kanë punuar në një projekt bashkë me autoritetet në disa komuna për kujdesin human ndaj kafshëve, të cilët kanë bërë vaksinimin, sterilizimin e qenve endacak, dhe jo vrasjen e tyre.

Ky projekt shërben për zbatimin e praktikave më të mira për mbrojtjen e kafshëve dhe eliminimin e rrezikut të qytetarëve nga qentë endacak.

“Merimangat e Pejës” kanë përfituar grantin për zhvillimin e turizmit alternativ, duke shënuar rrugët në pesë maje të bjeshkëve të Rugovës në Pejë dhe përgatitjen e hartave të shtypura dhe digjitale, si dhe hapjen e faqes së internetit në promovimin e këtyre majeve dhe atraksioneve tjera të Rugovës.



Nisma për Aktivizim, një organizatë e re në Ferizaj, e përbërë nga aktivistë të dikurshëm shkollarësh, ka zhvilluar projektin në mbështetje të të rinjve për t'u njohur me anën ligjore të trajtimit të tyre, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri dhe për nxitjen e aktivizmit të tyre në politikat publike.

“Gratë në Biznes”, janë duke zhvilluar projektin në tetë komuna për avansimin e pozitës së gruas në pjesëmarrjen e tyre në proceset e planifikimit të buxheteve komunale dhe aspekteve të barazisë gjinore në zhvillimin ekonomik.

OJQ “Koha” në Klinë ka punuar me 54 fshatrat e Klinës, duke organizuar takime me komunitetet për të forcuar dhe rritur pjesëmarrjen dhe ndikimin e qytetarëve në identifikimin e nevojave të tyre, caktimin e prioritetëve investuese dhe ndarjen e parasë publike sipas nevojave reale.



Shoqata e Miqësisë Kosovë-Izrael "Dr. Haim Abravanel" përmes ekspozitës artistike në Budapest (Hungari) ka prezantuar vlerat e fisnikërisë dhe bujarisë së popullit shqiptar për kujdesin e treguar ndaj popullit hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore.

"Crossing Bridges Production" ka prodhuar tre videospote të shkurtëra me porosi për ndotjet mjedisore nga thëngjilli, duke synuar vetëdijësimin mbi rrezikun dhe ndikimet në shëndetin publik të qymyrit, dhe për të kundërshtuar politikat energjetike të qeverisë.

Aktivitete tjera që kanë përfshirur vitin 2012

Vizita nga Miqtë e Tokës në Kosovë dhe realizimi i vizitës nga FIQ në Lindjen e Afërt

Gjatë vitit 2012, në kuadër të programeve që zhvillon, FIQ ka ndërmarrë edhe shumë iniciativa dhe aktivitete tjera. Ndër to është vizita e një delegacioni nga Miqtë e Tokës nga Lindja e Afërt në muajin gusht 2012. FIQ ishte nikoqir i kësaj vizite, e cila kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave me komunitete dhe institucione të ndryshme në Kosovë për të mësuar për përvojat e komuniteteve të ndryshme etnike në ndarjen e burimeve të përbashkëta natyrore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në shfrytëzimin e këtyre burimeve.

Ndërkaq, në muajin dhjetor 2012 FIQ realizoi vizitën në Lindjen e Afërt, ku u realizuan disa takime në lokalitete të ndryshme me deputetë parlamentari, kryetarë komunash, aktivistë mjedisor dhe përfaqësues të komuniteteve për të mësuar për përvojat në zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në ndarjen e burimeve të përbashkëta natyrore, edukimin në ruajtjen dhe shfrytëzimin e burimeve të ujit, si dhe ruajtjen e mjedisit.



FIQ merr pjesë në jurinë e DokuFest

Në vitin 2012, në jurinë përzgjedhëse të filmave në DokuFest në kategorinë Green Dox, morri pjesë znj. Mexhide Spahija, Drejtoreshë Ekzekutive e FIQ, kjo për shkak se FIQ është pjesë e Konzorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm – KOSID. Dokufest është Festivali Ndërkombëtar i Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar, që është ngjarja më e madhe e filmit në Kosovë. Festivali tradicionalisht organizohet në qytetin e bukur të Prizrenit.

FIQ merr pjesë në Grupin Punues për ndryshimin e udhëzimit administrativ për KKS-b-të

Zëvendës drejtori ekzekutiv i FIQ-it, Nazim Haliti ka marrë pjesë në punëtorinë treditore të Grupit Punues për ndryshimin e udhëzimit administrativ MPB 08/2009 dhe MAPL 02/2009 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, mbajtur në Shqipëri më 27-29 qershor. Grupi Punues është formuar nga MPB, duke marrë parasysh raportet dhe sygjerimet e vazhdueshme të disa institucioneve dhe organizatave, përfshirë dhe FIQ-in, për mosfunksionimin dhe mospërbushjen e mandatit dhe rolit të vet që kanë KKS-b-të në avancimin e sigurisë në bashkësi.

Forumi për Siguri: “Kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë –Progresi dhe sfidat”

Në muajin Mars 2012, në tryezën e organizuar nga Forumi për Siguri, me temën “Kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë –Progresi dhe sfidat”, u prezantua hulumtimi me po këtë titull.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të promovoj ndikimin e bërjes së politikave dhe marrjes së vendimeve në forcimin e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë. Hulumtimi “Kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta” analizon dhe vlerëson progresin e shënuar në hartimin e kornizës ligjore që rregullon kontrollimin e AVL-ve, duke u fokusuar në ligjet, strategjitë dhe politikat e përpiluara, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe mekanizmave për të siguruar kontroll efektiv të AVL-ve, zbatimin e ligjeve dhe strategjive, si dhe politikën e dënimeve për raste të mbajtjes së paligjshme të AVL-ve.



Tryezë diskutimi “Situatat emergjente në Kosovë - mobilizimi qytetar dhe kapacitetet institucionale”

Pas reshjeve të mëdha të borës në fillim të vitit 2012, dhe pas problemeve që shkaktoi moti, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), mbështetur nga organizata Saferworld nga Londra, organizoi tryezë diskutimi me temën “Situatat emergjente në Kosovë - mobilizimi qytetar dhe kapacitetet institucionale”.

Kryesisht u diskutua lidhur me atë se çka konsiderohet situatë emergjente, cilët janë hapat që duhen ndërmarrë nga institucionet e caktuara në raste emergjente, të bazuara në kuadrin ligjor ekzistues, cilët janë parametrat për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme dhe çështje tjera të kësaj natyre.



Seminar me komunitetin për "Zhvillimet në Sektorin e Energjisë në Kosovë

FIQ, në kuadër të aktiviteteve të Konzorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, KOSID, mbajti seminar me përfaqësues komunitetesh nga komuna të ndryshme të Kosovës, lidhur me projektet energjetike.

Me një përfaqësim të kënaqëshëm qoftë në nivel të diskutimeve, qoftë të përfaqësimit territorial, seminari nxorri në pah problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës, duke filluar nga problem bazike që janë mungesa e energjisë elektrike, rrjeti i dëmtuar, faturat jashtëzakonisht të ngritura e deri te probleme më të mëdha që konsistojnë në dëmet e shkaktuara nga termocentralet.

Stafi:

Dajana Berisha – Drejtore Ekzekutive

Nazim Haliti – Zv/drejtor Ekzekutiv

Kushtrim Puka – Menaxher i Programit

Sefë Govori – Menaxher i Financave

Arieta Rexhepi – Zyrtare e Programit dhe Komunikimit

Vjollca Islami Hajrullahu – Zyrtare e Programit

Për kontribut në FIQ gjatë vitit 2012, falenderojmë:

Mexhide Spahija

Fitim Hoxha

Fitore Gashi

Abion Sherifi dhe

Rina Baftiu

Falenderojmë



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World



SAFERWORLD
PREVENTING VIOLENT CONFLICT. BUILDING SAFER LIVES



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare
Forum for
Civic Initiatives



**Forumi për Iniciativa Qytetare
Forum for Civic Initiatives**

Rr.Rexhep Mala 5/A
10 000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 248 677
+386 (0) 43 733 454
info@fiq-fci.org
www.fiq-fci.org